



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Shkodër

VITI 2019

Tabela e Përmbajtjes

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020	3
Gjetjet kryesore.....	3
Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Shkodër.....	4
Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019	6
Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.....	6
Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.....	11
Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.....	16
Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër.....	18

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019.

Gjetjet kryesore

- Përgjatë vitit 2019 në Komisarariat qendër në Shkodër janë evidentuar 106 raste të dhunës në familje, ndërkohë që të dëmtuar gjithsej nga kjo dhunë ishin 114 persona nga të cilat 94 prej tyre gra/vajza.
- Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën janar – dhjetor 2019 janë paraqitur 174 kërkesa për UM dhe UMM.
- Përgjatë vitit 2019 Zyra rajonale e Përbarimit në Shkodër ka regjistruar dhe ekzekutuar 88 ekzekutime të vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër për Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes.
- Në total gjatë 2019-tës janë organizuar 37 aktivitete sensibilizuese, informuese, tryeza diskutimi dhe një prezantim raporti mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri me pjesëmarrje të 1000+ personave.
- Në lidhje me mbështetjen e rasteve të viktimave të dhunës në familje gjatë vitit 2019, Bashkia Shkodër ka bashkëpunuar me organizatat Shpresë për Botën dhe Qendra për Jetën "Shën Jozefi".
- GTN mbledhet ad-hoc, në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve ose brenda javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mbledhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin.
- Bashkia Shkodër ka nënshkruar rreth 16 marrëveshje me organizata të shoqërisë civile të cilat janë zbatuar përgjatë vitit 2019, por nuk kanë munguar edhe bashkëpunime të tjera me OSHC-të për të cilat jo detyrimisht është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.
- Gjatë vitit 2019 janë realizuar 4 trajnime me fokus punën për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe barazinë gjinore si dhe 1 trajnim i përbashkët i aktorëve të mekanizmit.
- Përgjatë vitit 2019 në total Mekanizmi i Referimit në Bashkinë Shkodër ka menaxhuar 59 raste të dhunës në familje.
- Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, shërbimi për trajtimin e dhunuesve është ofruar pranë Zyrës së Këshillimit për Djem dhe Burra (ZDB), degë e organizatës Gruaja tek Gruaja në Shkodër, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike dhe OJF-të që operojnë në këtë Bashki.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Shkodër

Statistikat e Drejtorisë së Policisë Shkodër¹

Përgjatë vitit 2019 në Komisaratin qendër në Shkodër janë evidentuar 106 raste të dhunës në familje, ndërkohë që të dëmtuar gjithsej nga kjo dhunë ishin 114 persona nga të cilat 94 prej tyre gra/vajza. Në vijim 36 ishin rastet e evidentuara në lidhje me veprën penale dhunë në familje sipas nenit 130/a, nga të cilët janë arrestuar 17 autorë. Detaje më të hollësishme pasqyrohen në tabelën e mëposhtme, me referenca nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë, Shkodër

Përshkrimi	Komisariati Shkodër
Evidentuar	106
Të dëmtuar gjithsej	114
Prej tyre gra/vajza	94
K-P.U.Mbrojtje	62
Sh.U.Mbrojtjes	2
V. P. Neni 130/a	36
Arrest. për 130/a	17
Ndalar për 130/a	4
Gjendje të Lirë për 130/a	17
Në kërkim për 130/a	1
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Një vepër penale e dhunës në familje ka për autor edhe të dëmtuar edhe subjektet e proceduar me kërkesë padi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes së menjëhershme. Të gjithë rastet e proceduara penalisht për shkelje të Nenit 130/a të Kodit Penal kanë pasur subjekt autorë të gjinisë mashkullore. Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar

¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Statistika nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër²

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me datë 02.02.2017, ka nënshkruar “Marrëveshjen Bashkëpunimi për ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të dhunës në marrdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Kjo marrëveshje është nënshkruar mes palëve : Bashkia Shkodër; Prefektura e Qarkut Shkodër; Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër; Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër; Zyra e Përmbarimit Shkodër; Shërbimi i Provës , Zyra Vendore Shkodër; Mjeku Ligjor Shkodër; Drejtoria Rajonale e Shëndëtit Publik Shkodër; Spitali Rajonal Shkodër; Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër; Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër; Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër; Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional; Shoqata apo “Gruaja tek Gruaja” Shkodër; Zyra e Keshillimit për djem dhe Burra Shkodër dhe Shoqata “Hapat e Lehtë” Shkodër

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën janar – dhjetor 2019 janë paraqitur 174 kërkesa për UM dhe UMM, nga të cilat gjykata vendosi që:

120 kërkesa të pranoheshin

44 kërkesa u vendos pushimi

21 kërkesa u rrëzuan

Ndërkohë që kjo gjykatë ka trajtuar 9 vendime ankimimi për Urdhrat e Mbrojtjes dhe ata të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Në lidhje me rastet e kallëzimeve penale për veprën penale të Dhunës në Familje të paraqitura pranë kësaj gjykate, referohet se së pari kallëzimet paraqiten në prokurori ose/dhe polici për çdo lloj vepre penale, njëkohësisht edhe për veprën penale të “Dhunë në Familje” parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal. Referuar sa më sipër në këtë gjykatë për periudhën janar – dhjetor 2019 janë regjistruar 65 çështje dhe shpallur fajtorë 45 autorë dhunues.

² Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Gjatë vitit 2019 janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas, në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017 dhe në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit të dhunës me bazë gjinore sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat.

Në total gjatë 2019-tës janë organizuar 37 aktivitete sensibilizuese, informuese, tryeza diskutimi dhe një prezantim raporti mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri.

Në aktivitetet e organizuara kanë marrë pjesë target grupe të ndryshme të komunitetit, si të rinjtë, gratë, vajzat dhe djemtë e Bashkisë Shkodër, me një pjesëmarrje rreth 1000 persona.

Buxheti në dispozicion të aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore, për periudhën janar- dhjetor 2019 është i ndarë në disa zëra:

1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje: 300 mijë lekë
2. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore për të cilin u alokuan: 200 mijë lekë
3. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi me një buxhet: 150 mijë lekësh.

Tabela 2. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	26 shkurt 2019	Qendra Rinore Atelie	Workshop “Street Art”, në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” Ekspoze e artit të rrugës, historia, tipare, teknika	Bashkia Shkodër Arte Foundation Gruaja tëk gruaja
2	27 shkurt 2019	Qendra Rinore Atelie	Workshop “Street Art”, në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” Diskutim i project-ideve të të rinjve për realizime grafiti në qytetin e Shkodrës	Bashkia Shkodër Arte Foundation Gruaja tëk gruaja
3	28 shkurt 2019	Qendra Rinore Atelie	Workshop “Street Art”, në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” Diskutim përfundimtar dhe përzgjedhja e ideve që do të realizohen	Bashkia Shkodër Arte Foundation Gruaja tek gruaja

4	4 mars 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Nr.3	Pse duhet të shqetësohem nga pabarazia gjinore?	Bashkia Shkodër Gruaja tek Gruaja
5	4 mars 2019	Qendra Rinore Atelie	Cinema gender “Roma”	Bashkia Shkodër Gruaja tek Gruaja
6	6 mars 2019	Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen”	Aktivitet sensibilizues me komunitetin e lagjes nr. 4, mbi rolin e gruas në familje	Bashkia Shkodër
7	7 mars 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Rrethina	Seancë informues me temë: Nëse jam viktimë e dhunës kujt t’i drejtohem?	Bashkia Shkodër Gruaja tek Gruaja
8	8 mars 2019	Pedonale “Kolë Idromeno”	Marshim paqësor #MeTy	Bashkia Shkodër Gruaja tek Gruaja
9	17 prill 2019	Salla OSBE-s, Bashkia Shkodër	Takim konsultues për raportin mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri	Bashkia Shkodër IDRA UN UN Women
10	22 maj 2019	Salla OSBE-s, Bashkia Shkodër	Prezantimi i raportit mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri	Bashkia Shkodër IDRA UN UN Women
11	27 maj 2019	Salla OSBE-s, Bashkia Shkodër	Tryezë diskutimi: Analiza e funksionimit të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës (MKR). Progreset, problematikat, nevojat dhe praktikatat e mira.	Bashkia Shkodër UNDP Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
12	31 maj 2019	Hotel Rozafa	Tryezë diskutimi : Stop dhunës me bazë gjinore! Niveli i zbatimit të objektivit të 3-të të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2016-2020	Gender Alliance for Development Center
13	07 tetor 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Nr.4	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e personave	Bashkia Shkodër Shkolla e mesme “ Kolë Idromeno”
14	08 tetor 2019	Shkolla e mesme “Adem Haxhija”, Postrisë	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e personave	Bashkia Shkodër

				Shkolla e mesme “Adem Haxhija”, Postrisë
15	09 tetor 2019	Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen	Aktivitet ndërgjegjësues mbi çështjet e trafikimit me komunitetin rom dhe egjiptian	Bashkia Shkodër Nisma për ndryshim shoqëror
16	10 tetor 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Nr.5	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e personave me prindërit	Bashkia Shkodër Terre Des Hommes
17	15 tetor 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Rrethina, Shtoj i Vjetër	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e fëmijëve	Bashkia Shkodër
18	18 tetor 2019	Shkolla e mesme “ Lucë Agraja”, Dajç	Ekspozitë me punimet e nxënësve rreth temës “Trafikimi i qenieve njerëzore”	Bashkia Shkodër Shkolla e mesme “ Lucë Agraja”, Dajç
19	18 tetor 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Gur i Zi	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e të rinjve	Bashkia Shkodër Shkolla e mesme “Atë Gjon Karma”, Gur i Zi
20	23 tetor 2019	Shkolla "Salo Halili”	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e fëmijëve	Bashkia Shkodër Nisma për ndryshim shoqëror Shkolla "Salo Halili”
21	24 tetor 2019	Shkolla "Ndoc Mazi"	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e personave	Bashkia Shkodër Shkolla "Ndoc Mazi"
22	25 tetor 2019	Shkolla “Hasan Dardhanjori”, Ana e Malit	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e personave	Bashkia Shkodër Shkolla “Hasan Dardhanjori”, Ana e Malit

23	29 tetor 2019	Shkolla e mesme "Shejnaze Juka"	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për trafikimin e personave me të rinjtë	Bashkia Shkodër Shkolla e mesme "Shejnaze Juka"
24	30 tetor 2019	Qendra Komunitare "Për Familjen" Dajç	Aktivitet psiko-social me interpretimet e fëmijëve	Bashkia Shkodër
25	26 nëntor 2019	Shkolla e mesme "Jordan Misja"	Seancë informuese me temë: "Dhuna dhe diskriminimi me bazë gjinore".	Bashkia Shkodër
26	27 nëntor 2019	Qendra Rinore Atelie	Thuaj jo dhunës, përmes artit.	Bashkia Shkodër
27	02 dhjetor 2019	Shkolla e mesme "28 Nëntori"	Seancë informuese me temë: "Angazhimi i të rinjve kundër dhunës me bazë gjinore" .	Bashkia Shkodër
28	02 dhjetor 2019	Qendra Komunitare "Për Familjen" nr. 3	Seancë informuese me temë: "Dhuna dhe diskriminimi me bazë gjinore".	Bashkia Shkodër
29	02 dhjetor 2019	Qendra Komunitare "Për Familjen" nr. 5	Mesazhe kundër dhunës.	Bashkia Shkodër
30	04 dhjetor 2019	Shkolla 9-vjecare "Shtoj i Ri"	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues mbi dhunën, format dhe pasojat e saj. Film N'Qendër - "The Blind Side".	Bashkia Shkodër
31	04 dhjetor 2019	Shkolla 9-vjeçare "Edith Durham"	Leksion i hapur mbi dhunën me bazë gjinore.	Bashkia Shkodër
32	05 dhjetor 2019	Shkolla e mesme "Luce Agraja"	Seancë informuese me temë: "Dhuna me bazë gjinore, fillon që në fëmijeri".	Bashkia Shkodër
33	05 dhjetor 2019	Shkolla 9-vjecare "Tring Smajli", Grudë e Re	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues mbi dhunën, format dhe pasojat e saj. Film N'Qendër - "The Blind Side".	Bashkia Shkodër
34	06 dhjetor 2019	Shkolla 9 vjecare "Hot i Ri"	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues mbi dhunën, format dhe pasojat e saj.	Bashkia Shkodër

			Film N'Qendër - "The Blind Side".	
35	06 dhjetor 2019	Shkolla e mesme "Adem Haxhija"	Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues mbi dhunën, format dhe pasojat e saj	Bashkia Shkodër
36	10 dhjetor 2019	Qendra Komunitare "Për Familjen" nr. 5	Diskutim: Dhuna më bazë gjinore.	Bashkia Shkodër
37	10 dhjetor 2019	Qendra Rinore Atelie	Ekspozita	Bashkia Shkodër

Ndërkohë që edhe anëtarët e mekanizmit të referimit të Bashkisë Shkodër kanë organizuar aktivitete të ndryshme për ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore apo/dhe asaj në familje.

Në kuadër të fushatës së përvitshme të muajit të marsit, "Gruaja tek Gruaja" në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe anëtarë të Mekanizmit të Referimit kundër dhunës me bazë gjinore hartuan një kalendar të përbashkët aktivitetesh ndërgjegjësuese i cili u implementua gjatë muajit Mars.

Seks? Faleminderit për ta provuar" - Gjatë Javës së Marsit, dedikuar grave, triumfi i suksesit ishte interpretimi i aktorit profesional të teatrit "Migjeni", Rita Gjeka, nën drejtimin e Merita Smaja, e cila mirëpriti për Shkodra publik: "Seks? Faleminderit vetëm për ta provuar", një monodramë e treguar për herë të 70-të. Monodrama vjen si një leksion mbi çështjet seksuale dhe seksuale të grave që vazhdojnë të konsiderohen tabu.

Shfaqja sot numëron 3000 shikues të ndërgjegjshëm për çështjen e seksualitetit, shëndetit riprodhues dhe të drejtave seksuale të grave, përmes teatrit interaktiv.

"Burrat dine me dashte" – u realizua ekspozita fotografike në bashkëpunim me bashkinë Shkodër, e cila përmban fotografi që tregojnë ndryshimin e roleve gjinore brenda familjes si dhe shoqërinë shqiptare të paraqitur përmes tregimeve personale me 22 karaktere; model dhe nxitës i ndryshimit të normave gjinore në shoqërinë tonë.

Takimi i komunitetit "Nëse unë jam viktimë, ku mund të kërkoj ndihmë?" - "Gruaja tek Gruaja" dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia Shkodër, duke ndjekur aktivitetet e ndërgjegjësimit të përbashkët gjatë javës së marsit mbajtën një takim me temën: "Nëse unë jam viktimë, ku edhe kërkoj ndihmë?", me pjesëmarrjen e 20 grave të komunitetit të Qendrës Shumëfunktionale "Për Familjet", Rrethina.

CinoDebate: Filmi "ROMA", - "Gruaja tek Gruaja", në bashkëpunim me Qendrën Rinore "Arka", Shkodër, së bashku me pjesëmarrësit e qendrës rinore, ishin pjesë e debatit në forum "Një përgjigje ndaj pabarazisë gjinore". Pas filmit "ROMA", u diskutuan çështjet e trajtuara në film në një

perspektivë gjinore dhe kishte shumë diskutime dhe ide në lidhje me përvojat dhe nevojat e grave dhe burrave si një dimension integral i politikave dhe programeve në aspektin politik, ekonomike dhe sociale.

Takimi në komunitet: Pse duhet të shqetësohem nga pabarazia gjinore ?! "- Në mars, u mbajtën" Gratë për Gratë "dhe Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia e Shkodrës, në vijim të aktiviteteve të ndërgjegjësimit të përbashkët një takim me temën: "Pse duhet të shqetësohem nga pabarazia gjinore?", me pjesëmarrjen e komunitetit të komunitetit "Për Familjet", nr 3.

Protesta e Zisë - 8 Mars - Viti 2019 për gratë në Shqipëri ka qenë e dhimbshme dhe e përgjakshme. Pothuajse çdo 7 ditë një grua është vrarë që nga fillimi i vitit. Duke filluar nga kjo situatë, Organizatat e shoqërisë civile vendosën të shpallin këtë 8 mars një ditë zie, por jo një ditë për të mbajtur zi në mënyrën tradicionale të zisë por për një ditë për të ngritur zërin kundër feminicidit. "Gruaja tek Gruaja" në bashkëpunim me institucionet e mekanizmit të referimit dhe aktivistët protestuan së bashku me pjesëmarrjen e kryetares së Bashkisë të Shkodrës, znj. Ademi në rrugën pedonale "Kol Idromeno", për të ngritur zërin për ata që nuk kanë zë dhe zgjedhje. Ka pasur 250 njerëz që protestonin nga Shkodra në emër të jetës, paqes dhe barazisë gjinore

Ky objektivi i strategjisë kërkon gjithashtu koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta, ndaj në këtë kuadër, bashkia Shkodër bashkëpunon me organizatat fetare si Madonina, Casa Mimosa, Shpresë për Botën, Ravasco, Motrat stigmatine, Qendra për Jetën "Shën Jozefi" në kuadër të një game të gjerë shërbimesh.

Në lidhje me mbështetjen e rasteve të viktimave të dhunës në familje gjate vitit 2019, Bashkia Shkodër ka bashkëpunuar me organizatat Shpresë për Botën dhe Qendra për Jetën "Shën Jozefi".

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare"(i ndryshuar), i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", Bashkia e Shkodrës në vitin 2017, ka koordinuar dhe nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës me rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup.

Bashkëpunimi midis këtyre institucioneve dhe organizatave përgjatë vitit 2019 ka qenë shumë i mirë. Të gjithë aktorët i janë përgjigjur në kohë nevojës për veprim dhe menaxhim të rasteve. GTN mbledhet ad-hoc, në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve ose brenda javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mbledhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin. (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare).

Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e riskut në të cilin ndodhet viktimja. Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mbledhet GTN, ndahen rolet e përgjegjësitë.

Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë.

Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e saj është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Bashkia Shkodër ka nënshkruar rreth 16 Marrëveshja të cilat janë zbatuar përgjatë vitit 2019, por nuk kanë munguar edhe bashkëpunime të tjera me OSHC-të për të cilat jo detyrimisht është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Bashkia e Shkodrës ka bashkëpunuar ngushtë përgjatë vitit 2019 me organizatën Gruaja te Gruaja, Terre Des Hommes Albania, Hapat e Lehtë, UN Women, UNDP, Albanian Disability Rights Foundation, Papa Giovanni XXIII, World Vision, Nisma për ndryshim shoqëror, Hope for the World, Gendere Alliance for Development Center për çështjet e dhunës me bazë gjinore.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 4 trajnime me fokus punën për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe barazinë gjinore si dhe 1 trajnim i përbashkët i aktorëve të mekanizmit.

Në vazhden e traditës së mirë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile Bashkia Shkodër ka patur bashkëpunim shumë të mirë me organizatat ndërkombëtare të tilla si: UNDP DHE UN WOMEN.

Përgjatë vitit 2019 në total Mekanizmi i Referimit në Bashkinë Shkodër ka menaxhuar 59 raste të dhunës në familje.

Çdo rast i trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, është trajtuar në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës dhe në bashkëpunim me institucionet / OSHC-të pjesë të MKR-së, dhe trajtimi i cdo rasti ka qënë I sukseshëm. Pavarësisht vështirësive janë dhënë shërbimet e nevojshme në varësi të problematikave të konstatuara.

Buxheti direkt i Bashkisë për dhunën në familje për vitin 2019 ishte 11 000 mijë lekë. Ndërsa buxheti indirekt përfshin edhe kohën e punës së specialistëve dhe të funksionimit të qendra Komunitare “Për Familjen” të cilat operojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Programi i strehimit për bonuset nuk ka gjetur zbatim gjatë vitit 2019 në Bashkinë Shkodër, ndaj kategoria e grave të dhunuara nuk ka pasur përfitues.

Bashkëpunimi midis Bashkisë së Shkodrës dhe Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Shkodër gjatë vitit 2019 ka qënë shumë i mirë. Të gjitha rastet e referuara janë menaxhuar me sukses dhe kanë kryer orët e punës në interes publik (pa pagesë) pranë institucioneve të varësisë së Bashkisë Shkodër.

Shërbimi i provës bashkëpunon me Zyrën për Djem dhe Burra për referimin e rasteve të djemve dhe burrave dhunues për të ndjekur programet e rehabilitimit për ndryshimin e sjelljeve të dhunëshme. Gjate vitit 2019 jne referuar 4 raste prane ZDB.

Përkohësisht koordinatore vendore e mekanizmit të referimit për rastet e dhunës me bazë gjinore është znj. Lorena Bardeli, e cila është njëkohësisht specialiste e sektorit të planifikimit strategjik, standarteve dhe monitorimit për shërbimet sociale dhe shëndetin publik.

Gjatë vitit 2019, koordinatorja ka marrë pjesë në 3 trajnime.

- Takim rajonal i koodinatorëve vendorë kundër dhunës mbi ndryshimet ligjore (UNDP).
- Workshop në kuadër të projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për barazi gjinore 2016-2020” (GADC)
- Sesion informues “Për një qasje gjithëpërfshirëse në shërbime ndaj grave e vajzave të dhunuara nga komuniteti rom/ egjiptian, LGBTI dhe atyre me aftësi të kufizuara”. (FSHDPAK)

Rastet e trajtuara nga Gruaja tek Gruaja Janar - Dhjetor 2019

Gruaja tek gruaja përgjatë vitit kalendarik 2019 ka trajtuar 384 raste gjithsej, ndër te cilat përfitueset kanë marrë

- 384 raste këshillim psikologjik
- 208 raste këshillim Juridik
- 82 përfaqesime në gjykatë
- 20 vlerësimë psikosociale

Në total janë realizuar rreth 700 seanca këshillimi nga kjo organizatë për viktimat e dhunës në familje 8 raste të grave të dhunuara janë strehuar pranë strehezes se emergjences të shoqëruara me 17 fëmijë.

Tabela 3. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2019 në Bashkinë Shkodër

Viti	Mbledhjet e ETN
2019	20.02.2019 ora 11:00 Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, në Bashkinë Shkodër, mbledhje e grupit teknik ndërsektorial, për të miturin B.K. në ambientet e Bashkisë Shkodër.
2019	Mbledhja e parë –17 prill 2019 Takim konsultues për raportin mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri
2019	Mbledhja e dytë – 22 maj 2019 Prezantimi i raportit mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri
2019	Mbledhja e tretë – 27 maj 2019 Tryezë diskutimi: Analiza e funksionimit të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës (MKR). Progreset, problematikat, nevojat dhe praktikat e mira.
2019	Mbledhja e katërt– 31 maj 2019 Tryezë diskutimi: Stop dhunës me bazë gjinore! Niveli i zbatimit të objektivit të 3-të të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2016-2020
2019	Mbledhja e pestë–2019 ETN- Rasti B.P
2019	Mbledhja e gjashtë– 04.10.2019 ETN- Rasti D.Ç

2019	Mbledhja e shtatë–12.11.2019 ETN- Rasti F.Q/ A.U
2019	Mbledhja e tetë– 22.11.2019 ETN- Rasti A.U

Burimi: Bashkia Shkodër

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Shkodër

Viti	Mbledhjet e KD
2019	0

Burimi: Burimi Bashkia Shkodër

Tabela 5. Lista emërore e Komitetit Drejtues – Bashkia Shkodër

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Voltana Ademi
Drejtoria e Policisë	Niko Brahimaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Arbër Çela
Prokuroria e Rrethit	Ylli Pjetërnikaj
Drejtoria Arsimore Rajonale	Kadri Ymeraj
Drejtoria e Shëndetit Publik	Lindita Haxhija
Zyra e Përmbarrimit	Enderson Memçaj
Prefektura	Çesk Millja
Drejtoria Rajonale e Shërvimit Kombëtar të Punësimit	Rozafa Zmijani
Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional	Meri Markici
Hapat e Lehtë	Denada Shpuza
Gruaja te gruaja	Majlinda Angoni
Shërbimi I Provës	Frida Dashi
Drejtoria e Shërbimit Social	Valbona Tula
Zyra për djem dhe burra	Endrit Uligaj
Komisariati i Policisë Shkodër	Lorenc Meta

Burimi: Bashkia Shkodër

Tabela 6. GTN-ja e Bashkisë Shkodër viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Lorena Bardeli

Drejtoria e Policisë	Dede Gazulli
Gjykata e RrethitGjyqësor	Blenda Behri
Prokuroria e Rrethit	
Drejtoria Arsimore Rajonale	Suela Domnori
Njësia vendore e kujdesit Shëndetësor, Shkodër	Stela Niklekaj
Zyra e Përmbartimit	Enderson Memcaj
Prefektura	Fluzela Zaja
Kryetarët e Njësive Administrative	
Zyra e Punësimit	Fatbardha Gradeci
Hapat e Lehtë	Denada Shpuza
Gruaja tek Gruaja/ Strehëzat për viktimat e dhunës	Sindi Kola/Atila Uligaj
Shërbimi I Provës	Nandi Samarxhi
Drejtoria e Shërbimit Social	Valbona Tula
Zyra për djem dhe burra	Endrit Uligaj
Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional	Eleonora Asllani

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, shërbimi për trajtimin e dhunuesve është ofruar pranë Zyrës së Këshillimit për Djem dhe Burra (ZDB), degë e organizatës Gruaja tek Gruaja në Shkodër, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike dhe OJF-të që operojnë në këtë Bashki. ZDB është pjesë e Mekanizmit të referimit kundër dhunës në familje në Bashkinë e Shkodrës, Bashkinë e Malësisë së Madhe dhe Vau Dejës, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me Gjykatën e rrethir Gjyqësor të Shkodrës, Drejtorinë e Policisë, Shërbimin e Provës, Dhomën e Avokatisë, Shërbimin Social Shtetëror si dhe organizatat e tjera që angazhohen në çështjet e dhunës në familje. Shërbimi për trajtimin e dhunuesve pranë ZDB, përmban komponentët e mëposhtëm:

- Këshillim individual ballë për ballë,
- Këshillim individual në telefon,

Kryesisht, klientët referohen pranë shërbimit nga institucionet partnere: Gjykatat, Policia, Shërbimi i Provës etj. Klientët paraqiten në çdo rast pranë zyrat e qendrës së shërbimit të shoqëruar, vetëm në takimin e parë, nga një punonjës i institucionit referues.

Praktikat e ndërhyrjes bazohen në besimin që dhuna është një sjellje e mësuar dhe burrat që kryejnë akte dhune, e kanë mundësinë dhe aftësinë për të modifikuar dhe ndryshuar sjelljet e tyre të dhunshme. Gjatë procesit të këshillimit fokusi vihet mbi temën e dhunës, mardhënien që klienti ka me dhunën, besimet, bindjet, traditat, modelet, normat e klientit dhe një peshë të madhe zë diskutimi mbi aktet e dhunës së kryer nga klienti dhe pasojat e kësaj dhune tek viktimat e tij. Këshilluesi e shoqëron klientin e tij drejt kuptimit dhe pranimit të përgjegjesive dhe pasojave të veprimeve të tij të dhunshme dhe gjetjes së motivimit për të ndryshuar sjellje.

Shërbimi i këshillimit jepet nga këshillues profesionistë të trajnuar dhe çertifikuar për ofrimin e këtij shërbimi dhe në ambjentet e ZDB-s të konceptuar enkas për këtë lloj shërbimi. Një cikël zgjat minimalisht 16 - 24 seanca. Seanca zgjat 50-55 minuta dhe çdo klient ndjek 1 seancë në javë. Shërbimi ofrohet falas për të gjithë klientet. Klientet që marrin këtë shërbim duhet të përmbahen kushteve dhe rregullave të caktuara, me të cilat njihen paraprakisht.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, pranë ZDB janë referuar 54 burra dhe djem me të cilët janë realizuar 222 seanca këshillimi në total. Nga këto raste, 23 klientë kanë ndërprerë procesin e këshillimit në fazë të herëshme ose kanë refuzuar të fillojnë procesin, raste për të cilat ZDB ka raportuar pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor, Shkodër.

Tabela 7. Referimet për personat dhunues

Institucioni Referues	Klientë
Gjykata e Rrethit	21
Sherbimi I Provës	4
Policia	5
Bashkia Shkoder	2
GTG	3
Vullnetare	11
Dhoma Avokatise	1
Azili I Pleqve	4
Shkolla	3
Total	54

Burimi: Zyra e Këshillimit për Djem dhe Burra

Përgjatë vitit 2019 Zyra rajonale e Përbarimit në Shkodër ka regjistruar dhe ekzekutuar 28 raste çështje përmbareme me objekt “pension ushqimor”, 9 çështje me objekt “takim fëmije” dhe 88 ekzekutime të vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër për Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Menjëherëshëm të Mbrojtjes.

Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër

Në bazë të monitorimit të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Shkodrës për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër:

- Bashkia e Shkodrës duhet të vijojë të angazhohet në rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për të mos pranuar dhe toleruar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.
- Trajnim i vazhdueshëm i stafit për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, mbi ndryshimet në legjislacionin shqiptar dhe mënyrat e ofrimit të shërbimeve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore është shumë i rëndësishëm. Ky rekomandim i përçuar pranë kësaj bashkie është përmirësuar dukshëm.
- Programi i strehimit për bonuset nuk ka gjetur zbatim as gjatë vitit 2019 në Bashkinë Shkodër (kategoria e grave të dhunuara nuk ka patur përfitues).
- Strehëza e emergjencës është një rast i mirë dhe model, megjithatë, monitorimi tregon se kapacitetet e strehëzës emergjente vijnë të jenë të kufizuara e më tepër burime financiare e njerëzore nevojiten, duke qenë se numri i rasteve për tu strehuar është përtej kapacitetit si dhe buxhetet janë të kufizuara për të mbuluar nevojat ushqimore.
- Rekomandohet një bashkëpunim më i ngushtë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër duke qenë se numri i vendimeve mbetet mjaft i ulët në krahasim më numrin e UMM/UM të pranuar nga gjykata. Sipas informacioneve nga ZDB, ky numër i ulët referimi vjen si pasojë e nivelit të ulët të ndërgjegjësimit të gjykatësve për nevojën e përfshirjes së dhunuesve në programe rehabilitimi.
- Rekomandohet informimi i viktimave apo/dhe dhunuesve për shërbimin e rehabilitimit.
- Roli i Koordinatorit Vendor të Dhunës është shumë i rëndësishëm në koordinimin dhe funksionimin e mekanizmit të referimit ndaj është e domosdoshme të rishikohet struktura aktuale e bashkisë për të siguruar burimet e duhura financiare dhe kohore për performimin e detyrave të koordinatorit vendor duke qenë se është e mbingarkuar.
- Referimi i rasteve të dhunuesve pranë Zyrës për Djem dhe Burra është një model pozitiv që duhet nxitur edhe në bashki të tjera të vendit ku shërbimet rehabilituese nuk janë të pranishme.

- Organizatat e shoqërisë civile në bashkinë e Shkodrës luajnë një rol të rëndësishëm e pozitiv veçanërisht në ofrimin e shërbimeve si ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje por duhet bërë më tepër për trajtimin e personave të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore.
- MKR Shkodër duhet të veprojë si një e tërë për të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore. Roli i çdo institucioni është shumë i rëndësishëm që rasti të marrë të gjithë ndihmën e duhur si viktima, fëmijët por edhe dhunuesi.
- Objektivi 3.3. është përmirësuar dukshëm në bashkinë Shkodër, por një aspekt që mund të përmirësohet në përmbushjen e tij është ndryshimi i mënyrës së mbledhjes së të dhënave dhe publikimi i statistikave nga shërbimi i provës. Disagregimi i të dhënave sipas gjinisë dhe llojit të veprës penale do të ndihmonte në analizim më të mirë të situatës dhe identifikimin e personave të dënuar për dhunë me bazë gjinore për ofrimin e shërbimeve për rehabilitimin e tyre.